Thirrje për bursa për studentët në kuadër të Programit Erasmus + për komponentin KA1 *International Credit Mobility* në Universitetin e Debrecen-it, Hungari.

Studentët që studiojnë në programet e studimit në gjuhën angleze që ofrohen nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti 'Ismail Qemali", Vlorë (UV), ftohen të aplikojnë për **tre** bursa për mobilitete shkëmbimi në Universitetin e Debrecen-it, Hungari (UD).

Mobiliteti për studentët përfshin qëndrimin prej pesë muajsh (shtator 2016-shkurt 2017) për të kryer studimet për një semestër. Në përfundim të mobilitetit studentët do të vijojnë studimet në universitetin e tyre të origjinës (UV). Ata nuk do të paguajnë asnjë tarifë shkollimi në universitetin pritës (UD), por do të vazhdojnë të paguajnë tarifat që aplikohen në universitetin e tyre të origjinës (UV).

Bursa përfshin:
- Kompensimin mujor (750 EUR/muaj);
- Shpenzimet e udhëtimit (275 EUR, vlerë e përcaktuar në bazë të largësisë midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Përllogaritja e largësisë bëhet në lidhjen e mëposhtme: http://ec.europa.eu/programm…/erasmus-plus/…/distance_en.htm).

Më shumë informacion rreth universitetit pritës (UD) do të gjeni në: http://ieas.unideb.hu/index.php?p=0&l=en.

Për të aplikuar, studentët e interesuar duhet të paraqesin brenda datës 29.06.2016, ora 12:00, pranë sekretarisë mësimore të Departamentit të Gjuhëve të Huaja, dokumentet e mëposhtme:

1. Kopje të dokumentit identifikues
2. Vërtetim studenti
3. Listë notash
4. Letër motivimi
5. Dy letra rekomandimi nga profesorë që kanë ndjekur veprimtarinë e studentit.

Për përzgjedhjen e kandidatëve fitues, do të ngrihet një komision vlerësues, në përbërje të të cilit do të ketë anëtarë të Departamentit të Gjuhëve të Huaja, një përfaqësues nga Zyra e Projekteve/Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë si dhe një anëtar të jashtëm nga një departament tjetër i Fakultetit të Shkencave Humane.
Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet mbi bazën e kritereve të mëposhtme (radhitur sipas rëndësisë):
1. Merita akademike
2. Kompetenca gjuhësore
3. Cikli i studimeve
4. Barazia gjinore (aty ku është e mundur të përzgjidhen kandidatë të barabartë në numër për nga gjinia).

Përpara fillimit të mobilitetit kandidatët fitues plotësojnë një *Learning Agreement* (Marrëveshje që vendoset midis studentit që aplikon dhe universitetit të origjinës, në të cilën paracaktohen kurset me kreditet përkatëse që studenti do të ndjekë gjatë semestrit në universitetin pritës, të cilat do t'i njihen në përfundim të tij dhe në vijim të studimeve në universitetin e origjinës).

Për më shumë informacion rreth skemës së mobilitetit dhe mënyrës së aplikimit, mund t'i referoheni broshurës së programit Erasmus +, http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/sites/erasmusplus/files/library//guide-credit-mobility_en.pdf ose të kontaktoni me Prof. As. Dr. Armela Panajotin, person kontakti për projektin.